

**DEPARTEMENT
BILDUNG, KULTUR UND SPORT**
Abteilung Volksschule

Albanisch

2026

BROSHURË

Informacion mbi pranimin në shkollat e mesme (Mittelschulen) dhe në shkollat profesionale (Berufsfachschulen mit Berufsmaturität) prej vitit shkollor 2026/27

1. Pranimi për nxënëset dhe nxënësit e shkollës Bezirk (Bezirksschule) dhe shkollës së mesme (Sekundarschule) në bazë të rezultateve.

Nxënësit dhe nxënëset e shkollës Bezirk dhe shkollës së mesme pranohen në bazë të notave në raportin e ndërmjetëm respektivisht me dëftesën përmbyllëse vjetore në shkollat e mesme, si shkolla e mesme ekonomike (Wirtschaftsmittelschule WMS), shkolla e mesme e informatikës (Informatikmittelschule IMS), shkolla e mesme pedagogjike, mjekësisë, sociale, arteve, komunikimit (Fachmittelschule FMS) si dhe në shkollat profesionale me maturë (Berufsfachschulen mit Berufsmaturität BMS).

Nxënësit dhe nxënëset e shkollës Bezirk kanë mundësi tjetër, që sipas mesatarës së notave në raportin e ndërmjetëm respektivisht në dëftesën vjetore të kualifikohen për gjimnaz (Gymnasium).

Lëndët që llogariten të pranohen, janë të njëjta si për nxënësit dhe nxënëset e shkollës Bezirk po ashtu dhe për nxënësit dhe nxënëset e shkollës së mesme.

Në shkollat e mesme (Gymnasium, WMS, IMS, FMS) pranohen zakonisht vetëm nxënës të cilët janë nën 18 vjeç në momentin e regjistrimit në shkollën e mesme.

2. Pranimi përfundimtar dhe jo përfundimtar

Nëse nxënësit dhe nxënëset i përmbushin kërkesat (shiko 3 dhe 4) në fund të semestrit të klasës së 3-të Berzirk – psh. shkolla e mesme (raport i përkohshëm) pranohen, por jo definitivisht si në gjimnazë, në shkollën e mesme ekonomike, në shkollën e mesme të informatikës, si dhe në shkollat e mesme pedagogjike, mjekësore, arteve, komunikimit, sociale. Kjo do të thotë që ata duhet të kalojnë kohën provë për shkollën e mesme përkatëse edhe për një simestër.

Nëse nxënësit dhe nxënëset i përmbushin kërkesat në fund të semestrit të dytë të klasës së 3-të Berzirk – psh. shkolla e mesme (raporti vjetor), pranohen në gjimnazë, në shkollën e mesme ekonomike, në shkollën e informatikës dhe në shkollën e mesme pedagogjike, mjekësisë, arteve, komunikimit, sociale.

Pranimi në shkollat profesionale në të dy rastet, pra në përmbushje të kërkesave në fund të semestrit të parë po ashtu edhe në fund të semestrit të dytë është përfundimtare.

3. Kërkesat për nxënësitt dhe nxënëset e shkollës Bezirk për pranim në gjimnazë, në shkollën e mesme ekonomike, në shkollën e mesme të informatikës, në shkollën e mesme pedagogjike, mjekësisë, arteve, komunikimit, sociale si dhe, në shkollat profesionale.

Për tu pranuar në gjimnaz pa provim, nxënësit dhe nxënëset në klasën e 3-të të shkollës së Bezirk duhet t'a përfundojnë me këto rezultate:

- Në raportin e ndërmjetëm respektivisht në dëftesën vjetore duhet në lëndët matematikë dhe gjermanisht të paktën të kenë notën 4,0.
- Mesatarja e notave në raportin e ndërmjetëm, dhe në dëftesën vjetore duhet sipas llogaritjes së tabelës 1 (shiko pika 5.) të paktën të kenë notën 4,7.

Për një pranim të lirë pa provim pranues në shkollën e mesme ekonomike, në shkollën e mesme të informatikës, në shkollën e mesme pedagogjike, mjekësisë, arteve, komunikimit, sociale dhe në shkollat profesionale duhet t'i përmbushin nxënësit dhe nxënëset e shkollës Bezirk në klasën e 3-të këto rezultate:

- Në raportin e ndërmjetëm si dhe në dëftesën vjetore në lëndët matematikë dhe gjermanisht të paktën duhet të kenë notën 4.
- Mesatarja e notave në raportin e ndërmjetëm si dhe në dëftesën vjetore të paktën duhet të jetë 4,4.

4. Kushtet për nxënësit dhe nxënëset e shkollës së mesme, për pranim në shkollën e mesme ekonomike, në shkollën e informatikës, në shkollën e mesme pedagogjike, mjekësisë, arteve, komunikimit, sociale dhe shkollat e mesme profesionale.

Për tu pranuar pa provim në shkollën e mesme ekonomike, në shkollën e mesme të informatikës, në shkollën e mesme pedagogjike, të mjekësisë, arteve, komunikimit, sociale dhe shkollës profesionale duhet që nxënësit dhe nxënëset e shkollës së mesme në klasën e 3-të të plotësojnë këto kushte:

- Në raportin e ndërmjetëm respektivisht në dëftesën vjetore duhet në lëndët matematikë dhe gjermanisht duhet të arrijnë notën 4,0.
- Mesatarja e notave në raportin e ndërmjetëm respektivisht në dëftesën vjetore duhet sipas llogaritjes së tabelës 1 (shiko pika 5.) të paktën të jetë nota 5,3.

5. Llogaritja e mesatares së notave

Mesatarja e notave llogaritet si mëposhtë:

Tabela 1: Llogaritja e mesatares së notave

Lënda	Numri notës	Shënime
Gjermanisht	Dyfish	Së paku duhet të arrihet nota 4.
Anglisht	Lehtë	-
Frengjisht	Lehtë	-
Matematik	Dyfish	Së paku duhet të arrihet nota 4.
Natyra dhe teknologji	Dyfish	-
Hapësira, koha, shoqëria	Dyfish	-

Lënda	Numri notës	Shënime
Edukim politik	Lehtë	Mesatarja aritmetike llogaritet nga të tre klasat në lëndët "Edukim politik", "Ekonomi, punë, familje" dhe "Shkenca e mediave dhe informatike" dhe rumbullakoset me presje dhjetore. Kjo notë ka rëndësi thjesht për mbledhjen dhe përlogaritjen e mesatares.
Ekonomia, puna, familja		
Media dhe Informatika		
Muzika	Lehtë	Mesatarja aritmetike llogaritet nga të tre klasat në lëndët "Muzikë", "Aktivitete dhe sport" dhe lënda me zgjedhje "Dizajn vizual" ose "Tekstile dhe dizajn teknik" dhe rumbullakoset me presje dhjetore. Kjo notë ka rëndësi thjesht për mbledhjen dhe përlogaritjen e mesatares. Nëse studenti ka ndjekur lëndën me zgjedhje "Projektet dhe kërkimet", mesatarja aritmetike llogaritet nga të dy klasat në lëndët "Muzikë" dhe "Aktivitete dhe sport" dhe rumbullakoset me presje dhjetore. Kjo notë ka rëndësi thjesht për mbledhjen dhe përlogaritjen e mesatares.
Aktiviteti dhe sporti		
Lëndë me zgjedhje		

6. Ankimimi

Mesatarja e pikëve të notës përkatëse të transferimit është një vendim që merret nga rrethi ose shkolla e mesme në fjalë. Rruga e ankesave është e njëjtë si për vendimet e tjera të aftësive brenda shkollës fillore: Nëse nuk mund të arrihet asnjë marrëveshje midis prindërve, nxënëses / nxënësit dhe mësuesit, zyra përgjegjëse për vendimin brenda komunës¹, pasi të jepet e drejta për t'u dëgjuar, duhet të marrë një vendim zyrtar, në përputhje me aftësitë.

7. Pranimi me provim

Provimi pranues është i hapur për nxënësit dhe nxënëset, të cilët vijnë nga një shkollë private apo vinë të jetojnë në kantonin e Aargaut si dhe për nxënësit dhe nxënëset të cilët nuk kanë mundur të kualifikohen pa provim pranues. Pjesëmarrja në provimin pranues për WMS, IMS, FMS dhe BMS lejohet për të diplomuarat dhe të diplomuarit të shkollës Bezirk dhe shkollës së mesme; provimi pranues për gjimnazin u drejtohet të diplomuarave dhe të diplomuarve të shkollës Bezirk. Nxënëse dhe nxënës, që vijnë prej një shkolle private ose që ndjekin një shkollim privat, marrin gjithashtu lejen të marrin pjesë në provimin pranues.

Provimi pranues për gjimnazë, për shkollën e mesme ekonomike, për shkollën e mesme të informatikës dhe shkollën të mesme pedagogjike, mjekësisë, arteve, komunikimit, dhe asaj sociale mund të kryhet në vitin në vijim pas përfundimit të shkollës së mesme apo në përfundim të shkollës Bezirk. Provimi pranues në shkollat profesionale mund të bëhet në përfundim të vitit shkollor. Nxënëse dhe nxënës prej një shkolle private ose nga shkollimi privat mund të bëjnë provimin pranues po ashtu në vitin e diplomimit.

Gjatë provimit pranues për shkollën e mesme profesionale ka provime me shkrim në lëndët gjermanisht, frëngjisht, anglisht dhe matematikë.

¹ Këshilli i komunës mban përgjegjësinë e përgjithshme për shkollën. Me vendime zyrtare shkollore, si për shembull vendime aftësie, këshilli i komunës mund të ngarkojë një anëtar të këshillit ose drejtorinë e shkollës. Çdo komunë përcakton në një rregullore, çfarë zyre është kompetente për marrjen e vendimeve zyrtare shkollore.

Gjatë provimeve pranuese për gjimnazin dhe shkollën e mesme ekonomike, shkollën e mesme të informatikës, shkollën e mesme të specializuar ka provime me shkrim në lëndët gjermanisht dhe matematikë.

8. Informim

Nxënësit dhe nxënëset me klasë përmbyllëse të shkollës Bezirk dhe shkollës së mesme mundet që, me pëlqimin e prindërve nga mesi i muajit Janar deri me 28. shkurt përmes platformes për paraqitje, që të informohen mbi shkollat e mesme që dëshirojnë. Departementi i Arsimit, Kulturës dhe Sportit (www.ag.ch/mittelschulen > Schultyp > Anmeldung)

9. Informacione shitesë

Informacione të tjera gjenden në www.ag.ch/leistungsbeurteilung-volksschule > [Übertrittsverfahren](#)
